



VERTETIM

Sot me date 27.06.2008, para meje MIMOZA SADUSHAJ, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha ", Pall. 13/1, u paraqit personalisht :ARJOLA JANI SHERI, lindur me 10.10.1983 ne Pogradec dhe banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, e njohur personalisht prej meje, e cila me paraqiti originalin e Vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane Nr 8778 AKTI, 22.06.2008

dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njeje me originalin.

NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 8778 AKTI

Nr.5259 VENDIMI

VENDIM
" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR : GJIN GJONI

asistuar nga sekretare gjyqesore **Pandora Gjini**, sot me dt 06.06.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike çështjen civile që i përket:

KERKUES: Vjollca Hoxha e bija Shaqirit dhe e Miles,e dtl. 1969, lindur dhe banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, perfaqesuar nga av Denis Selimi.

OBJEKTI: Leshimin e deshmi se trashegimise ligjore per te ndjerin Dritan Hoxha.

BAZA LIGJORE: Neni 348 e vijues të K.Civil.

Në përfundim të gjykimit, kerkuesi kërkoi pranimin e kërkesës. Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi dhe administroj provat;

VEREN

Se kërkesja i është drejtuar gjykatës me një kërkesë ku kërkon lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë në emër të bashkeshortit te saj të ndjerit Dritan Hoxha.

Nga hetimi gjyqësor i çështjes rezultojn e provuar se:

Në datën 23.05.2007 ka vdekur bashkeshorti i kerkueses, i ndjeri Dritan Hoxha, kjo e vërtetuar sipas certifikatës së vdekjes me Nr.1/67 date

28.05.2008. Sipas certifikatës të përbërjes familjare me Nr.1/67,date 28.05.2008, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Tirane Njesia Bashkiake nr.11, rezultoi se figurojne si trashëgimtarë ligjor të tij të radhës së pare këta persona: Vjollca Hoxha – bashkeshortja, Lorela Hoxha – e bija, Sara Hoxha, - e bija, Redia Hoxha- e bija dhe Itan Hoxha– i biri. Gjate gjykimit rezultoi se trashegimlenshi Dritan Hoxha, nuk rezultojn që të ketë lënë trashëgimtarë të tjerë ligjorë apo te kete femije jashtë martesë, gjithashtu të kete lënë testament.

Trashëgimtarët nuk rezultojnë të kenë hequr dorë nga trashëgimia apo te jenë të padenjë për të trashëguar.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çelja e kësaj dëshmie trashëgimie i kalojnë trashëgimtarëve në pjesë të barabartë nga 1/5 pjesë e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kudo qe ajo ndodhet.

Sa më sipër u arrit në seancë gjyqesore me spjegimet e kerkueses dhe provat e administruara. Në këto rrethana gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kerkuesja duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 306 e vijues të K.Pr.Civile ;

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses.
- Leshimin e deshmise se trashegimise ne emer te trashegimlenshit Dritan Hoxha, duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare:
 - Vjollca Hoxha
 - Lorela Hoxha
 - Sara Hoxha
 - Redia Hoxha
 - Itan Hoxha

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga çelja e kesaj deshmie trashegimie i kalojnë pasurise se luajtshme dhe te paluajtshme kudo qe ndodhet.

Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga nesermyja e shpalljes.

U shpall sot ne Tirane ,më datë 06.06.2008.

SEKRETARE
PANDORA GJINI

GJYQTAR
GJIN GJONI

Shpenzimet gjyqesore

Taksa pulle 100 leke

Totali 100 leke

VERTETOHET SE KY VENDIM
MORI FORME TE PREREMF DI
TIRANE 21.06.2008

23.06.2008 K/SEKRETARE
MIMOZA LULAJ

[Signature]

KANCELARI
VJARR SAULI